



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:235788

Datë: 12.09.2024

Numri i dokumentit: 06229832

KA.nr.815/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit BPrAl Kolegji “UBT-e”, SH.P.K. me NUI 810514853, me seli në Prishtinë Lagja “Kalabria”, kundër të paditurve 1.Ministria e Arsimit & Shkencës dhe e Teknologjisë me seli në Prishtinë përfaqësuar sipas autorizimit nga Avokatura Shtetërore 2. Agjencia e Akreditimit të Kosovës me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Z. S.B. për shkak të anulimit të Vendimit me nr.3178/21D i datës 09.09.2021 i plotësuar sipas vendimit Nr. Ref. 3236/21D i datës 21.09.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 10.09.2024, në mungesë të palës paditëse dhe të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës së parë, ndërsa me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës së dytë, më datë 12.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit BPrAl Kolegji “UBT-e”, SH.P.K. me NUI 810514853 me seli në Prishtinë kundër të paditurës së parë Ministria e Arsimit & Shkencës dhe e Teknologjisë me seli në Prishtinë dhe të paditurës së dytë Agjencia e Akreditimit të Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit me nr.3178/21D i datës 09.09.2021, i plotësuar sipas vendimit Nr. Ref. 3236/21D i datës 21.09.2021, ashtu që dispozitivi i vendimit që ka të bëjë me ndryshimin në pikën 4 të parimeve të manualit për Akreditim, pika 1.3; dhe 1.4 që ka të bëjë me kërkesë për Drejtor Menaxhues për secilën degë të IAL-së, konstatohet se është marrë në tejkalim të kompetencave ligjore të paditurës dhe si i tillë anulohet pjesërisht.

- II. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit BPrAl Kolegji “UBT-e”, për pjesën tjetër të Vendimit me nr.3178/21D i datës 09.09.2021, i plotësuar sipas vendimit Nr. Ref. 3236/21D i datës 21.09.2021, si e pabazuar.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 21.10.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi BPrAl Kolegji “UBT-e”, SH.P.K me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të autorizuar ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.2485/2021 kundër të paditurve 1.Ministria e Arsimit & Shkencës dhe e Teknologjisë me seli në Prishtinë 2. Agjencia e Akreditimit të Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të Vendimit nr.3178/21D i datës 09.09.2021 i plotësuar sipas vendimit Nr. Ref. 3236/21D i datës 21.09.2021, me propozim që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar në ligj, të anulohet vendimi nr.3178/21D i datës 09.09.2021 i plotësuar sipas vendimit Nr. Ref. 3236/21D i datës 21.09.2021, të detyrohet e paditura që paditësin si dhe BPrAL tjerë ti trajtoj në procedurë të ardhshme të akreditimit dhe ri akreditimit, ti trajtojnë në përputhje të plotë me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Udhëzim Administrativ UA 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 815/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor dhe publik më datë 10.09.2024 konform nenit 41 të LKA-së në mungesë të palës paditëse të ftuar në mënyrë të rregullt ftesën për seancë e ka pranuar më datë 29.08.2024 dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditurës së parë të përfaqësuar nga avokatura shtetërore, e cila është ftuar në mënyrë të rregullt mirëpo e ka refuzuar më datë 03.09.2024 me arsyetim të pabazuar që ftesa ti dërgohet të paditurës së dytë, ndërsa me pjesëmarrje të përfaqësuesit të paditurës së dytë Z.S.B. sipas autorizimit të datës 05.09.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi ka deklaruar se me vendimin nr. Ref. 3236/21 D të datës 21.09.202 është bërë plotësim ndryshimi i vendimit me nr. 3178/21D i datës 09.09.2021 i ndryshuar më datë 27.09.2021 me ç ‘rast janë plotësuar “Parimet Themelore të Manualit për Akreditim”, duke u shtuar pikat 3,4,5 duke u vendosur kriteret e reja për akreditim dhe riakreditim përvës standardeve të përcaktuara në manualin ekzistues dhe Ua 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës. Sipas tij, me vendimin e goditur e paditura ka bërë shkeljen e dispozitave respektive të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), duke mos zbatuar drejtë dispozitat ligjore të këtij ligji përkatësisht nenet 44 deri në nenin 48 për faktin se arsyetimi i këtij vendimi përmban të dhëna të paqarta kontradiktore ose të pa sakta dhe i njëjti është i barasvlershëm me mungesën e plotë të arsyetimit të vendimit administrativ.
5. Tutje ka elaboruar duke paraqitur mes tjerash shkeljet e përgjithshme materialo-juridike të vendimit të kundërshtuar duke theksuar se pika 5 e vendimit të kundërshtuar është në kundërshtim me UA Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës përkatësisht Nenit 10 par 1.2 të këtij Udhëzimi Administrativ në të cilin sanksionohet se Këshilli Shtetëror i Cilësisë do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimeve i cili parashtrohet për aplikim nga Institucionet e Arsimit të Lartë, ndërsa me nenin 26 par.2.3.4 të po këtij Udhëzimi Administrativ përcaktohet se *“për programet e studimit të nivelit bachelor dhe master kërkohet të ketë të paktën një staf me marrëdhënie të rregulla pune me titullin PhD nga fusha e studimeve dhe i cili i dedikohet për një grup të studenteve dhe mbulon 60 ECTS”*. Neni 2 par.3.11 përcakton lejimi që për programet infermieri BSc Mami Bsc dhe gjuha e shenjave të hyjnë në akreditim dhe me mungesë të stafit PhD, ndërsa neni 26 par. 5.3.12 sanksionohet që *“e drejta e institucionit për të promovuar stafin e tij akademik në shkallë të caktuar rregullohet me nenin 26 të IAL-së”*, ndërsa kriteret e institucionit duhet të përcaktohen në statutin e tij dhe duhet të jenë të hapur për shqyrtim nga Agjencia Kosovare e Akreditimit.
6. Ka shtuar se Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mënyrë arbitrare ka përjashtuar tri platforma të tjera të parapara me UA 15/2018, për faktin se përcaktimi i dy revistave në vendimin

me nr. Ref. 3236/21D i datës 09.09.2021 ku janë përcaktuar kriteret në pikën 5 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim për hulumtim shkencor për bartësit e programeve në nivele *bachelor* dhe *master* janë në kundërshtim me nenin 3 par.1 të UA 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension. Pika 4 e parimeve të përgjithshme të manualit për akreditim me të cilin përcaktohen kriteret për akreditim të degëve të IAL-ve në Vendimin nr. Ref: 3236/21D në nënpikën 1.1 theksohet që “në degë ofrohen vetëm programe të nivelit Bachelor” (niveli VI sipas KKK) është në kundërshtim të plotë me nenin 6 të IAL-së për shkak se aty përcaktohet se “asgjë në këtë ligj ose në instrumentet plotësuese të nxjerra sipas tij apo në dispozitat e çfarëdo ligji tjetër, nuk do të kufizojnë lirinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë, ndërsa në pikën 6.2 të kësaj dispozite ligjore përcaktohet se “për të ofruar kurse të çdo niveli arsimor për përvetësimin e aftësive që janë të nevojshme ose të përshtatshme për realizimin e qëllimeve të arsimit të lartë dhe për dhënien e kontributit në të mësuarit gjithë jetës”.

7. Përfundimisht ka deklaruar se pika 4 e parimeve të përgjithshme të manualit për akreditim me të cilin përcaktohen kriteret për akreditim të degëve të IAL-ve në vendimin nr. Ref: 3236/21D në nënpikën.1.4 “*Struktura menaxhuese/organizative e Degës të IAL-ve duhet të përbëhet së paku nga Drejtori/Menaxheri i degës dhe një koordinator për çdo program të studimit të ofruar në degë.*”, ndërsa vendimi i goditur me padi është kundërthënës për faktin se aty thuhet që “*struktura e mësipërme menaxhuese/organizative në degë, nuk mund të jetë e njëjtë me strukturën Menaxhues/organizative të kampusit kryesor*”. Pika 4 e vendimit Ref: 3236/21D e datës 21.09.2021 është në kundërshtim të plotë me dispozitat e LSHT ngase degët tek një BPrAL si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar “nuk kanë subjektivitet juridik dhe as cilësinë e personit juridik për të hyrë në qarkullim juridik nga cilado bazë juridike qoftë ajo, si dhe u mungon legjitimiteti real pasiv që të jenë palë në procedurë”, ngase degët njësit e ngjashme janë degëzime që i përkasin sistemit unik në kuadër të BPrAL si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe me tipare të plota të personit juridik.

Kundërshtimet e të paditurës

8. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi, sipas parashtresës së datës 29.10.2021 dhe parashtresës së datës 10.09.2024 ka deklaruar se Ligji për

Arsimin e Lartë e përcakton qartazi AKA-në si agjenci të pavarur, i cili ka mandat të bërjes së politikave dhe përcaktimit të kriterëve dhe standardeve të cilësisë në arsimin e lartë. Të gjitha politikat, standardet dhe kriteret të cilat e rregullojnë sistemin e sigurimit të cilësisë dhe akreditimin në arsimin e lartë janë të vendosura në dokumentin i cili njihet me termin Manuali për Akreditim, ndërsa KSHC i AKA-së ka përditësuar këtë manual duke shtuar dhe definuar disa kritere i cili bazohet në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe në UA 15/2018. Pretendimet e paditësit se vendimi nuk përmban arsyetim janë absurde dhe të pa baza kjo për faktin se KShC nuk ka nxjerr vendim i cili atakon apo afekton IAL-të mirëpo ka përditësuar manualin e saj për akreditim dokument i cili i përcakton kriteret standardet dhe politikat për të gjitha IAL-të njëloj.

9. Tutje sipas tij pretendimet e paditësit për diskriminim është i pa pazë për faktin se vendimet e kontestuar kanë efekt juridik *erga omnes* për të gjitha institucionet e IAL ndërsa konform nenit 49 par. 1 pika 1.3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA) është përcaktuar se “akti administrative i nxjerr sipas detyrës zyrtare nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale.
10. Ka theksuar se sa i përket pretendimit të paditësit se platformat e përcaktuara nga AKA janë më të limituara dhe përjashtuese në krahasim me platformat e përcaktuara me UA të MASHT, dhe nuk janë relevante për AKA-në i cili udhëzim ka për synim që të rregulloj procesin akademik brenda Universiteteve Publike në Republikën e Kosovës dhe ky UA nuk ka të bëjë fare me publikimet si kriter për sigurim të cilësisë dhe është kriter i vendosur nga MASHT përmes një Udhëzimi Administrativ i cili nuk i dedikohet fare Agjencisë për Akreditim, AKA ka vendosur vetë që ti pranoj këto dy platforma si të vlefshme për faktin se shumica e vendeve anëtarë të ENQA-së që zbatojnë standardet ndërkombëtare të cilësisë kanë bërë të njëjtën pasi që shumica e platformave dhe revistave të tjera ishin futur në të ashtuquajturën “Lista e Billit”, e cila është platformë jo kredibile dhe është e përjashtuar.
11. Përfundimisht ka deklaruar se sa i përket pikës V të paditësit në padi, e paditura e konsideron këtë pikë si të pa paqëndrueshme, për faktin se vendimi i AKA-së është mirëpritur nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe i njëjti është kundërshtuar vetëm nga paditësi. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadija e

paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi me nr. 3178/21D i datës 09.09.2021 i plotësuar me vendimin nr. 3236/21D të datës 21.09.2021.

Provat e administruara

12. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendimi me nr. 3178/21D i datës 09.09.2021, Vendimi me nr. 3236/21 i datës 21.09.2021
13. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Nga provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:
14. Nga Vendimi me nr. 3178/21D i datës 09.09.2021, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka marr vendim me nr. 3178/21D të datës 09.09.2021 për plotësimin e parimeve themelore të Manualit Për Akreditim, respektivisht janë shtuar pikat 3,4 dhe 5. Në pikën 3 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim vendosen kriteret për akreditim të programeve të Mjekësisë së përgjithshme, Në pikën 4 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim vendosen kriteret për akreditim e degëve të IAL-ve të cilat përcaktojnë se: Në pikën nr. 5 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim, vendosen kriteret për hulumtim shkencor për bartësit e programeve në nivel BA dhe MA.
15. Me Vendimin me nr. 3236/21 i datës 21.09.2021 Agjencia e Kosovës për Akreditim ka marr vendim me nr. 3236/21D të datës 21.09.2021 për plotësim ndryshimin e vendimit 3178/21D të datës 09.09.2021 me qëllim për plotësimin e parimeve themelore të Manualit për Akreditim, respektivisht janë shtuar pikat 3,4 dhe 5.
- 15.1 Në pikën 3 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim vendosen kriteret për akreditim të programeve të Mjekësisë së përgjithshme, ku përcaktohet se: për programet të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome në fushën e mjekësisë së

përgjithshme, përveç standardeve të përcaktuara në manual IAL-të duhet të dëshmoj me dokumente adekuate që i ka të funksionalizuara dhe në posedim klinikat dhe shërbimet shëndetësore si: Klinikën e Neurokirurgjisë, Kirurgjisë, e Kirurgjisë së Fëmijëve, Kirurgjisë Plastike, Kirurgjisë Torokale, Vaskulare, Oftamologjisë, Maksilofaciale, Ortopedisë me Traumatologji, Gjinekologjike Obstetrike, e ORL-së, Urologjisë, Anestezionit, Biokimisë Mjekësore, Radiologjisë, Hematologjisë, Nefralogjisë, Kardiologjisë, Reumatologjisë, Gastroenterologjisë, Klinika Infektive, Psikiatrisë, Neurologjisë, Dermatovenerologjisë, Pediatriisë, Neunatologjisë, Pulmologjisë, Fiziatriisë me rehabilitim fiskal, Onkologjisë Mjekësore, Alergiologjisë me Imunologji, Klinika e Endokrinologjisë.

15.2 Në pikën 4 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim vendosen kriteret për akreditim e degëve të IAL-ve të cilat përcaktojnë se: Në degët e IAL-vë mund të ofrohen vetëm programe të nivelit bachelor (Niveli VI sipas KKK), Secila degë dhe të posedoj një plan zhvillimor të ndarë nga kampusi kryesor, Institucioni në degë duhet të dëshmojë që ka strukturë të ndarë menaxheriale/organizative dhe të sigurimit të cilësisë nga kampusi qendror, Struktura menaxhuese/organizative e degëve të IAL-ve duhet të përbëhet së paku nga drejtori/menaxheri i degës, një koordinator për çdo program të studimit të ofruar në degë struktura e mësipërme menaxhuese/organizative në degë, nuk mund të jetë e njëjtë me strukturën menaxhuese organizative të kampusit kryesor, struktura për sigurimin e cilësisë duhet të përbëhet së paku nga një koordinator për sigurimin e cilësisë, Institucioni duhet të dëshmojë me raporte për vlerësimet që i realizon në degë, IAL duhet të dëshmojë se i ka shërbimet administrative të këshillimit dhe orientimit në karrierë ndarazi nga kampusi kryesor në qendër, Secila degë duhet të posedoj marrëveshje të bashkëpunimit me industrinë relevante me të cilat dega funksionon, IAL duhet të dëshmojë se ka në dispozicion laborator dhe mjete tjera të konkretizimit, IAL duhet të dëshmojë se ka në dispozicion të mjaftueshëm të librave fizik dhe online, si dhe qasje në platformat online të hulumtimit.

15.3 Në pikën nr. 5 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim, vendosen kriteret për hulumtim shkencor dhe titujt akademik për bartësit e programeve në nivelin BA/BSc dhe MA/MSc, ku përcaktohet: nga 1 Tetori 2021 përveç kriterëve të përcaktuara me UA për Akreditim, për bartësit e programeve që hyjnë në proces të

akreditimit në nivelin BA/BSc duhet të ketë të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të ketë të paktën 2(dy) punime nga fusha e studimit/programit në revista shkencore të indeksuara si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 Ëeb of Sciences koleksioni bërthamë (SCIE, SSCI, dhe AHCI), dhe 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat apo shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHT. Nga 1 Tetori 2022, përveç kriterëve të përcaktuara me UA për Akreditim, bartësit e programeve në nivelin BA/BSc duhet të kenë thirrje akademike Prof.Ass dhe të paktën 1 (një), publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike prof.Ass dhe 2 (dy) punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3 pika 1.1 Ëeb of Sciences koleksioni bërthamë (CIE, SSCI dhe AHCI), dhe 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat apo shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI. Përjashtim bëjnë bartësit e programeve studimore/Akademike të përcaktuar sipas nenit 26 pika 11e Ligjit për Arsimin e Lartë.

Vlerësimi i gjykatës

16. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit, kundërshtimet e të paditurës dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.
17. Gjykata shqyrtoj vendimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 9 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LKA-së) i cili përcakton se: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.
18. Vendimi i kundërshtuar si akt administrativ i përgjithshëm, siç përcaktohet në Nenin 44 LKA-së, i drejtohet një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të

karakteristikave të përgjithshme (në vijim: “akti administrativ i përgjithshëm”), me të cilin ndryshohet Manuali për akreditim për Institucionet e Arsimit të Lartë i cili ndikon në interesat juridike të paditësit BPrAl Kolegji “UBT-e”, SH.P.K.

19. Gjykata vlerëson se Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (LALK), neni 7, përcakton bazën ligjorë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim AKA si agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë përmes proceseve profesionale dhe transparente të vlerësimit dhe kontrollit të cilësisë apo mjeteve të tjera që konsiderohen të përshtatshme nga ajo, të cilat i plotësojnë praktikën më të mira ndërkombëtare. Më tutje përcakton, AKA-ja siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë në Kosovë të plotësojë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. (ENQA)” Neni 15 përcakton Akreditimi dhe vlerësimi i cilësisë, 1. Të gjithë bartësit e licencuar të arsimit të lartë u nënshtrohen procedurave të kontrollit dhe vlerësimit të cilësisë nga AKA-ja në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore. Ndërsa, Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr.15/2018, Neni 4 përcakton strukturën organizative të AKA-së ku par. 2.1 përcakton se “Këshilli Shtetëror i Cilësisë është organ politik bërës dhe vendimmarrësi i AKA-së.
20. Gjykata vlerëson se Vendimi me nr. 3236/21 i datës 21.09.2021 i Agjencia e Kosovës për Akreditim për plotësim ndryshimin e vendimit 3178/21D të datës 09.09.2021, si dhe vendimi i ndryshuar me për plotësimin e parimeve themelore të Manualit për Akreditim, është pjesërisht në përputhje me përgjegjësitë dhe autorizimet ligjorë të paditurës sipas LALK-së, për sigurimin e cilësisë, vlerësimin dhe akreditim e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.
21. Me Vendimi me nr. 3178/21D i datës 09.09.2021, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka marr vendim me nr. 3178/21D të datës 09.09.2021 për plotësimin e parimeve themelore të Manualit për Akreditim, respektivisht janë shtuar pikat 3,4 dhe 5. Ndërsa me Vendimin me nr. 3236/21 i datës 21.09.2021 për plotësim ndryshimin e vendimit 3178/21D të datës 09.09.2021 janë shtuar pikat 3, 4 dhe 5. Në pikën 3 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim vendosen kriteret për akreditim të programeve të Mjekësisë së përgjithshme, ku përcaktohet se: për programet të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome në fushën e mjekësisë së përgjithshme, përveç standardeve të përcaktuar në manual IAL-të duhet të dëshmoj me dokumente adekuate që i ka të funksionalizuara dhe

në posedim klinikat dhe shërbimet shëndetësore si: Klinikën e Neurokirurgjisë, Kirurgjisë, e Kirurgjisë së Fëmijëve, Kirurgjisë Plastike, Kirurgjisë Torokale, Vaskulare, Oftamologjisë, Maksilofaciale, Ortopedisë me Traumatologji, Gjinekologjike Obstetrike, e ORL-së, Urologjisë, Anastezionit, Biokimisë Mjekësore, Radiologjisë, Hematologjisë, Nefralogjisës, Kardiologjisë, Reumatologjisë, Gastroenterologjisë, Klinika Infektive, Psikiatrisë, Neurologjisë, Dermatovenerologjisë, Pediatriisë, Neunatologjisë, Pulmologjisë, Fiziatriisë me rehabilitim fiskal, Onkologjisë Mjekësore, Alergiologjisë me Imunologji, Klinika e Endokrinologjisë.

22. Gjykata vlerëson se kjo pikë e vendimit në përputhje me Nenin 14 të LALK-së, ku përcaktohet Licencimi i bartësve të arsimit të lartë, paragrafi 4 ku përcaktohet Kriteret e licencimit përveç akreditimit nga AKA, si parakusht kryesor, përfshijnë dispozita lidhur me: *4.1. përshtatshmërinë e mjediseve dhe Pajisjeve*; Neni 5. përcakton kërkesa të tjera shtesë për licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë të nxirren në dokumentet plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij. ... *5.2. objektet dhe burimet e tjera fizike të cilat janë të përshtatshme për punën arsimore të bartësit, të sigurta dhe të përshtatshme për qëllimin dhe për të cilat bartësi e ka titullin e plotë ligjor.* Prandaj gjykata vlerëson se kërkesa për plotësimin e kushteve në manual që IAL-të të dëshmojnë me dokumente adekuate që i ka të funksionalizuara dhe në posedim klinikat dhe shërbimet shëndetësore për secilin program adekuat është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të LALK-së.
23. Gjykata vlerëson se ndryshimet lidhur me pikën 4 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim, specifikisht kërkesa që ka të bëjë me strukturën menaxheriale që IAL të dëshmojnë *Institucioni në degë duhet të dëshmojë që ka strukturë të ndarë menaxheriale/organizative nga kampusi qendror, ashtu që Struktura menaxhuese/organizative e degëve të IAL-ve duhet të përbëhet së paku nga drejtori/menaxheri i degës,* është në kundërshtim me dispozitat e LALK, Neni 6 ku përcaktohen Kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë në ofrimin e Arsimit të Lartë ku përcaktohet se *Ministria është përgjegjëse për: 1.2. rregullimin e statusit të bartësve publik dhe privatë të arsimit të lartë dhe miratimin e statuteve të tyre.* Neni 11. paragrafi 2 përcakton *Kompanitë private, fondacionet dhe trustet mund të themelojnë institucione të arsimit të lartë. Statutet e tyre do të përcaktojnë strukturën e qeverisjes dhe të menaxhimit të institucionit, së bashku me misionin dhe qëllimet e tyre strategjike.* Neni

12 paragrafi 7 përcakton se *një bartës privat i arsimit të lartë gëzon lirinë që në statutin e tij apo në dokumente të tjera themeluese të aprovojë çfarëdo modeli të qeverisjes dhe të menaxhimit, me kusht që ky model të ndajë në mënyrë të qartë rolin dhe kompetencat e pronarëve nga vendimet për çështjet akademike si dhe të lejojë pjesëmarrjen e personelit mësimdhënës dhe të studentëve në vendimmarrje lidhur me çështjet akademike.* Neni 17 rregullon Statutin e bartësve të arsimit të lartë ku përcakton: **1. Funksionimi dhe menaxhimi i bartësit publik të arsimit të lartë përcaktohet në statut të propozuar nga ana e Ministrisë dhe të miratuar nga Kuvendi. Ky statut mund të ndryshohet në përputhje me dispozitat e tij dhe me pëlqimin e Ministrisë dhe miratimin nga ana e Kuvendit. 2. Statutet e të gjithë bartësve të tjerë dhe çdo ndryshim në to miratohen vetëm nga Ministria.**

24. Prandaj, gjykata vlerëson se nuk është në kompetencë ligjore të AKA-së që të ndryshoj strukturën menaxhuese të IAL-të, duke përcaktuar strukturë menaxhuese për menaxher të zyrës, respektivisht drejtor menaxhues sepse një kërkesë e tillë është edhe në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, **Neni 107 ku si kërkesë minimale përcakton që** Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar menaxhohet nga së paku një drejtor menaxhues, dhe jo që secila degë apo filialë e shpk të këtë nga një drejtor menaxhues, sepse kjo nënkupton që e paditura në këtë rast AKA ka përcaktuar kërkesa për strukturën menaxhuese që nuk janë paraparë as me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, duke e detyruar IAL që për çdo degë, të caktoj drejtor menaxhues. Sipas Nenit 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare secili drejtor menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësojë Shoqërinë me Përgjegjësi, e sipas nenit 33 të këtij ligji paragrafi 1.3 pika të dhënat për drejtor menaxhues duhet të regjistrohen në ARBK dhe të numri i tyre të përcaktohet me Statutin e SHPK-së, ashtu siq u tha më lartë është ndryshimet në statusin e IAL janë në kompetencë të Ministrisë. Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë pikë AKA i ka tejkalluar kompetencat ligjore që janë të përcaktuara për Ministrinë dhe ka përcaktuar kritere në kundërshtim me dispozitat e LALK-se dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare të cituara më lart.

25. Ndërsa, pjesërisht ndryshimi që sa i përket Manualit me të cilën kërkohet që IAL në Degë të ketë koordinator për sigurimin e cilësisë, gjykata vlerëson se është në përputhje me përgjegjësitë ligjore të AKA-së për sigurimin e cilësisë sepse Institucioni duhet të ofroj cilësi dëshmoj përmes shërbimeve administrative të këshillimit dhe orientimit në karrierë

përveç se në kampusin kryesor në qendër edhe ene degë dhe poashtu duhet të ketë në dispozicion laborator dhe mjete tjera të konkretizimit, dhe të ketë në dispozicion të mjaftueshëm të librave fizik dhe online, si dhe qasje në platformat online të hulumtimit që kanë për qëllim ngritje e cilësisë së arsimit.

26. Po ashtu, Gjykata vlerëson se ndryshimet në pikën nr. 5 të parimeve të përgjithshme të Manualit për Akreditim, me të cilën vendosen kriteret për hulumtim shkencor dhe titujt akademik për bartësit e programeve në nivelin BA/BSc dhe MA/MSc, ku përcaktohet: *nga 1 Tetori 2021 përveç kriterëve të përcaktuara me UA për Akreditim, për bartësit e programeve që hyjnë në proces të akreditimit në nivelin BA/BSc duhet të ketë të paktën 1 (një) publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit/programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të ketë të paktën 2(dy) punime nga fusha e studimit/programit në revista shkencore të indeksuara si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3, pika 1.1 Ëeb of Sciences koleksioni bërthamë (SCIE, SSCI, dhe AHCI), dhe 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat apo shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHT. Nga 1 Tetori 2022, përveç kriterëve të përcaktuara me UA për Akreditim, bartësit e programeve në nivelin BA/BSc duhet të kenë thirrje akademike Prof.Ass dhe të paktën 1 (një), publikim shkencor të indeksuar nga fusha e studimit programit, ndërsa në nivelin MA/MSc duhet të kenë të paktën thirrjen akademike prof.Ass dhe 2 (dy) punime në revista shkencore të indeksuara nga fusha e studimit/programit, si autor i parë apo korrespondent, sipas nenit 3 pika 1.1 Ëeb of Sciences koleksioni bërthamë (CIE, SSCI dhe AHCI), dhe 1.2 SCOPUS, duke përjashtuar revistat apo shtëpitë botuese të dyshimta sipas UA 01/2018 të aprovuar nga MASHTI. Përjashtim bëjnë bartësit e programeve studimore/Akademike të përcaktuar sipas nenit 26 pika 11e Ligjit për Arsimin e Lartë, janë në përputhje me Ligjit për Arsimin e Lartë, Nenin Neni 26 ku përcaktohen Titujt dhe gradat e personelit paragrafi 4. Profesorët e rregullt, profesorët e asociuar dhe profesorët asistentë duhet të kenë të përfunduara doktoratë **dhe të kenë një sfond të suksesshëm të publikimit në revista me recension ndërkombëtar.** Profesorët e rregulltë gjithashtu duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë udhëheqje të suksesshme akademike përmes hartimit të kurrikulit, risive pedagogjike, hulumtimit dhe publikimit së paku për tetë (8) vjet.*

27. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative,

gjkata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale, gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.815/22, datë 12.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.